

Procesverbal

Konsultim publik: *Me Banorët e Njesisë Administrative Lopës*

Data: 11/12/2025

Ora: 10:00

Vendi: Qendra e fshatit Sinanaj

Numri i pjesëmarrësve: Gjithësej 38 persona të pranishëm. (11 gra dhe 27 burra).

1. Titulli i Projekt – aktit që konsultohet: Projekt draft programit buxhetor afatmesem 2026-2028, paketa fiskale dhe projekt buxhetin e vitit 2026.

2. Pjesëmarrës :

1. **Gramos Sako** (Kryetar i Bashkisë)
2. **Valbona Cela** (Sekretare Këshilli)
3. **Arben Gumeni** (Kryetar i Këshillit)
4. **Ela Skenderaj** (Koordinatori informimit)
5. **Gazmend Groshi,** (Drejtorja e Tatim Taksave)
6. **Blerina Kasneci** (Drejtorja e Tatim Taksave)
7. **Arta Shaha** (Drejtoreshë Arsimit - Kulturës)
8. **Gezim Shehu** (Drejtori Zhvillimi Rural)
9. **Ervin Panidha** (DPKZHT)
10. **Adi Vela** (DSHP)
11. **Mjaftoni Zera** (Anëtare Këshilli)
12. **Latif Kacaj** (Anëtar Këshilli)
13. **Aleksandër Toti** (Kabineti Kryetarit)

• **Administratori i Njesisë Lopës, Z. Artur Ormeni:**

Pershendetje te gjithëve, faleminderit per pjesemarrjen ne kete degjese te organizuar nga keshilli bashkiak per PBA2026-2028, projekt buxhetin 2026. Ju jeni sot ketu per te shprehur shqetsimet dhe kerkesat tuaja per ti reflektuar ne buxhetine vitit 2026. Problematika ne njesine tone rruget e brendshme te fshatrave, restaurimi i lerave, furnizimi me uje ne fshatin Sinanaj.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni:

Ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë takim konsultues për PBA 2026–2028 dhe projektbuxhetin 2026. Qëllimi i këtij takimi është mbledhja e kërkesave dhe prioriteteve tuaja lidhur me zhvillimin e zonës, në mënyrë që ato të pasqyrohen në buxhetin e vitit 2026 dhe në PBA 2026–2028.

Fokusi kryesor i diskutimit është përmirësimi i infrastrukturës dhe zhvillimi i turizmit. Ju ftoj të paraqisni mendimet dhe propozimet tuaja, të cilat do të merren në konsideratë gjatë hartimit të dokumenteve buxhetore.

Kryetari i Bashkisë, z. Gramos Sako

Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë dëgjese. Kemi ardhur për të dëgjuar kërkesat tuaja dhe për t'ju informuar mbi punët e kryera në Njësinë Administrative Lopës.

Gjatë këtij viti jemi fokusuar te shërbimet bazë për komunitetin, si:

- pastrimi,
- ndriçimi publik,
- mirëmbajtja e varrezave publike,
- mirëmbajtja e rrugëve rurale,
- mirëmbajtja e çezmave publike.

Për vitin 2026 synojmë të ndërhyjmë në:

- rrugët e brendshme të fshatrave Dhemblan dhe Matohasanaj,
- mirëmbajtjen e varrezave publike
- përfundimin e mirëmbajtjes dhe arredimit të zyrave,
- asfaltimin e rrugës Qafë Mehmetaj – Dhemblan (prioritet),
- mirëmbajtjen e rrugës Matohasanaj,
- si edhe ndërhyrje të tjera sipas nevojave të komunitetit.

Pjesëmarrësit që morën fjalën dhe diskutuan dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet si vijon:

Kryetari i fshatit Dhëmban Z. Ilir Llanaj:

Kërkohet ndërhyrje në zyrat e kryesisë së fshatit Dhëmban, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës së tyre. Një problematikë e vazhdueshme mbeten varrezat e fshatit, të cilat kërkojnë pastrim dhe mirëmbajtje. Në territorin e fshatit Dhëmbanit ndodhen gjashtë qendra varresh, të cilat duhet të mirëmbahen rregullisht.

Ndriçimi publik paraqet ende vështirësi, ndaj kërkohet përmirësimi i tij. Gjithashtu, çdo punë e nisur duhet të ndiqet deri në përfundim dhe të verifikohet nga ju.

Në Dhëmbllan janë realizuar rreth 50% e investimeve të planifikuara, si ndërtimi i çezmave dhe sistemimi i qendrës së fshatit. Megjithatë, problematikë mbetet shkolla, e cila kërkon ndërhyrje.

Varrezat e fshatit kërkojnë rrethim, pastrim dhe sistemim. Ndriçimi publik duhet përmirësuar dhe çezmat kërkojnë riparim. Po ashtu, propozohet mbjellja e pemëve në qendër të fshatit dhe pranë Lapidarit, për gjelbërimin e zonës.

Kryetari i fshatit Lab Martalloz, Z. Jaho Sulaj:

- Kërkesat I kam paraqitur më parë me shkrim.
- Tek varrezat e fshatit po ndërtohet një objekt, të cilin banorët e kanë kundërshtuar.
- Varrezat duhet të pastrohen dhe të mirëmbahen.
- Ndriçimi publik është problematik dhe kërkon ndërhyrje.
- Çezma në fshat duhet të riparohet.

Kryetari i fshatit Sinanaj Z. Adif Ormeni:

Nuk jemi këtu për të kërkuar llogari sot. Problematikat që paraqesim janë si vijon:

- Uji i pijshëm në fshatin Sinanaj, kërkohet vendosja e një pompe, pasi distanca nga depoja është e shkurtër.
- Rruga Sinanaj – Dashaj – Kërkohet ndërhyrje për përmirësimin e saj.

Kryetari i Bashkisë, z. Gramos Sako, sqaroi se ujësjellësi administrohet nga Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, por Bashkia do të shqyrtojë këtë problematikë dhe do të bashkëpunojë për zgjidhjen e saj.

Banori i fshatit Sinanaj, z. Njazi Bega, paraqiti këto problematika:

- Rruga Sinanaj – Sevaster të shtrohet me asfalt.
- Uji i pijshëm në fshatin Sinanaj – të hartohet projekti për furnizimin me ujë.
- Mirëmbajtja e lërave ekzistuese.
- Projekt për Pastrimin e kullotave.

Banori i fshatit Sinanaj, z. Nuri Muçi, paraqiti këto problematika;

- Mirëmbajtja e lërave për kullota
- Uji i pijshëm mbetet problematik për fshatin Sinanaj dhe kërkon zgjidhje.
- Mirëmbajtja e rrugëve brenda fshatit.
- Mbledhja e të ardhurave nga toka bujqësore,
- Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Sinanaj, i cili kërkon zgjidhje të menjëhershme.

Kryetari i fshatit Dorëz Z. Kadri Dervishi paraqiti këto problematika:

- Rrugat e fshatit Dorëz paraqet vështirësi dhe kërkon ndërhyrje. (ura me tubina) Rrepja
- Mali i fshatit Dorëz në këtë zonë ndodhen dy lëra të mëdha, por për to nuk paguhet

Banori i fshatit Sinanaj, z. Kujtim Ahmetaj, paraqiti këto problematika:

- Uji i pijshëm për fshatin Sinanaj – depoja ekziston, por kërkohet vendosja e tubacioneve për të siguruar furnizim të rregullt me ujë.
- Rruga Matohasanaj kërkon ndërhyrje për përmirësim

Banori i fshatit Sinanaj, z. Hetem Zeraj, paraqiti këto problematika:

- Rruga Sevaster – Vlorë është premtuar
- Rruga Matohasanaj aktualisht ka projekt preventiv; gjatësia e saj është rreth 2.8 km
- Ndriçimi publik mbetet problematik në disa zona të fshatit.
- Rrethimi i varrezave.

Kryetari i fshatit Matohasanaj, z. Bako Luzi, paraqiti këto kërkesa dhe problematika:

- Rruga në fshatin Matohasanaj
- Mirëmbajtja e lërave – rikonstruksion dhe mirëmbajtje.
- Ndriçimi publik – ndërhyrje për të përmirësuar ndriçimin, duke ndërruar dhe riparuar llambat e dëmtuara.
- Shkolla e ciklit të ulët – aktualisht ndodhet në kushte jo optimale për mësim kërkohet izolim dhe përmirësim i ambientit.

Banori i fshatit Sinanaj, z. Brahim Kamberi, paraqiti këto problematika:

- Uji i pijshëm në fshatin Sinanaj – furnizimi me ujë mbetet problematik.
- Kanalizimi i ujërave të zeza mungesa e sistemit të kanalizimeve

Banori i fshatit Sinanaj, z. Adriatik Meta, paraqiti këto problematika:

- Lëra në sheshin e madh
- Pastrimi i rrugës Sinanaj – Tepelenë

Ju faleminderit,

Mbajtëse e P/Verbalit Sekretare Këshillit

Valbona Çela



Koordinatorë Informimit Konsultimit Publik

Ela Skënderaj

